

Fjalat e Paqes



*Nëse ndokush më do,
ai do të ma mbajë fjalën,
Ati im do ta dojë,
tek ai do të vijmë
dhe do të banojmë.
Gjn 14, 23*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 4 (129) Viti XVIII Qershor-Korrik 2016

PAPA FRANÇESKU NË ARMENI



Ati i Shenjtë Françesku bëri Udhëtimin Apostolik në Armeni me dt. 24-26 qershor 2016. Në vijim deklarata e përbashkët e Shenjtërisë së Tij Françeskut dhe Shenjtërisë së Tij Karekini II, që bënë në Etchmiadzin, Pallati Apostolik, e diel, 26 qershor 2016.

Sot në Etchmiadzin-in e Shenjtë, qendër shpirtërore e të Gjithë Armenëve, ne, Papa Françesku dhe Karekini II, Catholicos i të Gjithë Armenëve, lartësojmë mendjet tona dhe zemrat tona për të falënderuar të Gjithëpushtetshmin për afërsinë e vazhdueshme e gjithnjë më të madhe në fe e në dashuri mes Kishës Kishës Apostolike Armene dhe Kishës Katolike në dëshminë e tyre të përbashkët të mesazhit të Ungjillit në një botë të sakatuar nga konfliktet dhe që dëshiron ngushëllim e shpresë. Lavdërojmë Trininë e Shenjtë, Atin, Birin e Shpirtin Shenjt, që na ka lejuar të vijmë në tokën biblike të Araratit, që lartësohet si për të na

kujtuar se Hyji do të jetë gjithmonë mbrojtja dhe shëlbimi ynë. Jemi shpirtërisht të kënaqur të kujtojmë se në vitin 2001, me rastin e 1700-vjetorit të shpalljes së Krishterimit si besim i Armenisë, shën Gjon Pali II vizitoi Armeninë dhe që dëshmitar i një faqeje të re të marrëdhënieve të ngrohta e vëllazërore mes Kishës Apostolike Armene dhe Kishës Katolike. Jemi mirënjohës që kemi pasur hirin të jemi së bashku në një liturgji solemne në Bazilikën e Shën Pjetrit në Romë më 12 prill 2015, në të cilën jemi angazhuar t'i



kundërvihemi çdo forme diskriminimi e dhune, dhe kemi përkujtuar viktimat e asaj që Deklarata e Përbashkët e Shenjtërisë së Tij Gjon Pali II dhe Shenjtërisë së Tij Karekini II e quajti «shfarosja e një milion e gjysëm të Krishterësh Armenë, që përgjithësisht përkufizohet si genocidi i parë i shekullit XX» (27 shtator 2001). Lavdërojmë Zotin për faktin se sot feja e krishterë është përsëri një realiteti gjallë në Armeni dhe se Kisha Armene çon përpara misionin e vet me një shpirt bashkëpunimi vëllazëror mes Kishave, duke i mbështetur besimtarët në ndërtimin e një bote solidariteti, drejtësie dhe paqeje.

Megjithatë, mjerisht jemi dëshmitarë të një tragjedie shumë të madhe që po ndodh para syve tanë: për persona të panumërt e të pafajshëm që vriten, deportohen apo detyrohen të përballojnë një mërgim të dhimbshëm e të pasigurt për shkak të konflikteve të vazhdueshme me bazë etnike, politike e fetare në Lindjen e Mesme dhe në anë të tjera të botës. Prej kësaj del se pakicat etnike e fetare janë bërë objektivi i përndjekjeve dhe i trajtimeve mizore, deri në atë pikë sa këto vuajtje për arsye të përkatësisë në një konfesion fetar janë bërë një realitet i përditshëm. Martirët u përkasin të gjitha Kishave dhe vuajtja e tyre përbën një “ekumenizëm gjaku” që i tejkalon përçarjet historike mes të krishterëve, duke i thirrur të gjithë që të nxisin njësinë e dukshme të nxënësve të Krishtit. Së bashku lutemi, me ndërmjetësinë e shenjtërve Apostuj Pjetër dhe Pal, Tade e Bartolome, për një ndryshim të zemrës në të gjithë ata që i kryejnë këto krime dhe në ata që janë në gjendje të ndalin dhunën. U lutemi krerëve të kombeve që ta dëgjojnë kërkesën e miliona qenieve njerëzore, që presin me ankth paqe e drejtësi në botë, që kërkojnë respektimin e të drejtave që u ka dhënë Hyji, që kanë nevojë të ngutshme për bukë, jo për armë. Mjerisht po asistojmë në një paraqitje të besimit dhe të vlerave fetare në një mënyrë fundamentaliste, që përdoret për të shfaqësuar përhapjen e urrejtjes, të diskriminimit dhe të dhunës. Shfaqësimi i këtyre krimeve në bazë të ideve fetare është i papranueshëm, sepse «Hyji nuk është shkaktues çrregullimesh, por i paqes» (1Kor 14,33). Gjithashtu, respekti për ndryshimet fetare është

kushti i nevojshëm për bashkëjetesën paqësore të bashkësive të ndryshme etnike dhe fetare. Pikërisht sepse jemi të krishterë, jemi të thirrur të kërkojmë dhe të zhvillojmë rrugë pajtimi e paqeje. Në lidhje me këtë shprehim edhe shpresën tonë për një zgjidhje paqësore të çështjeve në lidhje me Nagorno-Karabakh.

Duke pasur parasysh atë që Jezusi u ka mësuar nxënësve të vet kur ka thënë: «Pata uri e më dhatë të ha, pata etje e më dhatë të pi, isha shtegtar e më përbujtët, isha i zhveshur e më veshët, i sëmurë e erdhët të

Vijon në fq. 2 ►

PAPA FRANÇESKU NË ARMENI

◀ *Vijim i fq. 1*

më shihni, isha në burg e erdhët tek unë» (Mt 25, 35-36), u kërkojmë besimtarëve të Kishave tona që t'i hapin zemrat e tyre dhe duart e tyre për viktimat e luftës e të terrorizmit, për refugjatët dhe familjet e tyre. Është në lojë vetë kuptimi i njerëzimit tonë, i solidaritetit, dhembshurisë e bujarisë sonë, që mund të shprehet në mënyrë të përshtatshme vetëm nëpërmjet një përdorimi të menjëhershëm e praktik të burimeve. E pranojmë se të gjitha këto janë bërë më parë, por theksojmë se shumë më tepër kërkohet nga ana e përgjegjësve politikë dhe e bashkësisë ndërkombëtare me qëllim që të sigurohet e drejta e të gjithëve për të jetuar në paqe e siguri, për të mbështetur shtetin e së drejtës, për të mbrojtur pakicat fetare dhe etnike, për të luftuar trafikun dhe kontrabandën e qenieve njerëzore.

Shekullarizimi i sektorëve të gjerë të shoqërisë, largimi i saj nga ajo që është shpirtërore dhe hyjnore, në mënyrë të pashmangshme çon në një vizion të desakralizuar dhe materialist të njeriut dhe të familjes njerëzore. Për sa i përket kësaj jemi të shqetësuar për krizën e familjes në shumë vende. Kisha Apostolike Armene dhe Kisha Katolike bashkëndajnë të njëjtin vizion të familjes, të bazuar në martesën, akt dhurimi falas dhe dashurie besnike mes një burri dhe një gruaje.

Jemi të lumtur të pohojmë se, pavarësisht prej përçarjeve të vazhdueshme mes të Krishterëve, e kemi kuptuar më qartë se ajo që na bashkon është shumë më madhe se ajo që na ndan. Kjo është baza e qëndrueshme mbi të cilën njësisia e Kishës së Krishtit do të bëhet e dukshme, sipas fjalëve të Zotërisë: «që të gjithë të jenë një» (Gjn 17,21). Në dhjetëvjeçarët e kaluar marrëdhëniet mes Kishës Apostolike Armene dhe Kishës Katolike kanë hyrë me sukses në një fazë të re, të forcuara

prej lutjeve tona të ndërsjella dhe prej angazhimit tonë të përbashkët për t'i kapërcyer sfidat aktuale. Sot jemi të bindur për rëndësinë kyçe që ka zhvillimi i këtyre marrëdhënieve, duke ndërmarrë një bashkëpunim të thellë dhe më vendimtar jo vetëm në fushën teologjike, por edhe në lutje e në një bashkëveprim aktiv në nivel të bashkësive lokale, në perspektivën e bashkëndarjes së një bashkimi të plotë dhe shprehjeve konkrete të njësisë. I nxisim besimtarët tanë të punojnë në harmoni për të nxitur në shoqëri vlerat e krishtera e krishtera, që ndihmojnë në mënyrë efikase për ndërtimin e një qytetërimi drejtësie, paqeje dhe solidariteti njerëzor. Rruga e pajtimit dhe e vëllazërisë është e hapur para nesh. Shpirti Shenjt, që na drejton kah gjithë e vërteta (krh. Gjn 16,13), përkrahtë çdo përpjekjetë njëmendtë për të ndërtuar ura dashurie dhe bashkimi mes nesh.

Nga Etchmiadzin-i i Shenjtë i ftojme të gjithë besimtarët tanë të bashkohen me ne në lutje, me fjalët e Shën Nerses Shnorhali: «O Zot i Lavdishëm, pranoji lutjet e shërbëtorëve të Tu, dhe me dashamirësi plotësoji kërkesat tona, me ndërmjetësinë e Shenjtes Nënë të Hyjit, të shën Gjon Pagëzuesit, të shën Shtjefnit Protomartir, të shën Gregor Ndriçuesit, të shenjtërve Apostuj, të Profetëve, të "Hyjnorëve" të Shenjtë, të Martirëve, të Patriarkëve, të Eremitëve, të Virgjërave dhe të të gjithë shenjtërve të Tu në qiell e në tokë. Dhe Ty, o Trini e Shenjtë e pandashme, të qoftë lavd e nder në shekuj të shekujve Amen».

Shenjtëria e Tij Françesku

Shenjtëria e Tij Karekini II

DEKLARATË PËR SHTYP E KOMUNITETEVE TË KRISHTERA NË SHQIPËRI

Ne Komunitetet e Krishtera të Shqipërisë (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë), jemi duke ndjekur me interes dhe shqetësim rrugëtimin e reformës në drejtësi gjatë gjithë kohës që flitet për të. Në mënyra të ndryshme, kemi thënë fjalën tonë për këtë reformë në përgjithësi apo për aspekte të veçanta të saj.

Në këtë moment kaq delikat, kur po afrohet data dhe mundësia për t'i dhënë vendit një reformë në drejtësi, e cila është ndër hallkat më problematike të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare, dhe që prek drejtpërdrejtë jetën dhe cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë, i bëjmë thirrje sensit të përgjegjësive të faktorëve dhe liderëve politikë, që të gjejnë me patjetër një konsensus për këtë reformë ashtu siç edhe faktori ndërkombëtar është duke theksuar. Gjetja e një gjuhe të përbashkët në interes të vendit, jashtë interesit vetjak apo të një grupimi të caktuar politik, është sot misioni juaj i madh.

Drejhtësia dhe zbatimi i përpiktë i saj nuk është një zgjedhje në jetën e një populli që synon të jetë një vend demokratik, por

element themelor, për të cilin duhet të kontribuojmë të gjithë që të garantojmë ndarjen nga korrupsioni, i cili si gangrenë rrezikon shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe të shoqërisë.

Gjetja e konsensusit për miratimin e reformës në drejtësi jemi të bindur se do të shtojë besimin e popullit tek faktori politik dhe do të ndikojë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë, ku shteti i së drejtës do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe të së mirës së përbashkët.

Orët në vazhdim janë shumë të rëndësishme dhe jetike për këtë reformë. Ne besojmë se ka ende hapësira për t'u ulur dhe për të lënë mënjane retorikën konfliktuale. Populli pret shumë nga ju e nga ne të gjithë, që në mënyra të ndryshme duhet të kontribuojmë në përmirësimin e jetës së tij.

Ne premtojmë lutjet tona dhe të besimtarëve tanë drejtuar Zotit, për gjetjen e një gjuhe të përbashkët dhe miratimin e kësaj reforme. Paqja e Zotit qoftë me ju!

Tiranë, më 20 korrik 2016

KISHA NË SHQIPËRI PER SULMIN TERRORIST NË FRANCË: “TË FORCOJMË BASHKËPUNIMIN NDËRFETAR”

Ne një deklaratë për shtyp, Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë shpreh dënimin e saj për sulmin terrorist në Francë dhe bën thirrje për një bashkëpunim më të madh ndërfaqësor e ndërinsitucional. Ja deklarat e zyrës së Shtypit e Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë:

“Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pult, në emër të ipeshkëvinjëve katolikë të Shqipërisë dënon ashpër sulmin terrorist në Nice të Francës mbrëmjen e kaluar. Ndërkohë shprehim ngushëllimet e lutemi për viktimat e këtij akti terrori. Ajo çka ka ndodhur në Francë është një gjë shumë e rëndë që, sëbashku me aktet e tjera në Francë, Belgjikë, Turqi, e në vend të Lindjes së Mesme duhet të zgjojnë vetëdijen tonë dhe reagimin

qytetar. Ndërkohë duhet të forcojmë bashkëpunimin ndërfaqësor dhe ndërinsitucional që t'u paraprijmë akteve të tilla, sidomos nëpërmjet edukimit qytetar, civil dhe religjioz me ndjenjat e paqes, të bashkëjetesës dhe të harmonisë. Kisha katolike në Shqipëri nxit çdolloj veprimi dhe nisme në të mirë të bashkëjetesës dhe sigurisë në vend duke përfshirë këtu edhe Reformën në drejtësi që këto ditë pritet të miratohet. Kjo do të ndihmonte edhe në këtë drejtim, në forcimin e organeve të drejtësisë dhe në besimin te ligji dhe te e mira.

Mbetemi me shpresë dhe i lutemi Zotit që akte të tilla të mos përsëriten më.”

Tiranë, 15.07.2016

PËRKUSHTIMI I KISHËS SË “SHËN KJARËS SË ASIZIT”



Më 21 prill 2016, një ngjarje kishtarë gëzon popullin e Hyjit: Përkushtimi i kishës së Manastirit kushtuar “Shën Kjarës së Asizit” në Shkodër. Por çfarë do të thotë? Si lind ky vend në qendër të qytetit? Dhe, çfarë do të thotë: kishë e manastirit?

Shumë meshtarë, misionarë, rregulltarë e rregulltare të dioqezave shqiptare dhe prej disa vendeve italiane u mbledhën rreth Ipeshkvit Metropolitan të Shkodër-Pultit, Imzot Angelo Massafra-s, Nuncit Apostolik Ramiro Moliner Inglès, Ipeshkvit të Lezhës Imzot Ottavio Vitale, Atit Aurel Gjerka, Atit Lovro Gavran dhe bashkësisë së Motrave të Varfra të Shën Kjarës për të kremtuar me gëzim Përkushtimin e kishës së manastirit. Mes tyre ishin edhe Fretërit Minorë të Provincës Françeskane të Lecce-s dhe meshtarët e Dioqezës së Otranto-s, të cilët sollën në procesion reliket e Martirëve të Shenjtë të Otranto-s, me qëllim që të vendosen brenda altarit të ri.

Për ta kremtuar festën me Motrat Klarise e Manastirit të Shkodrës ishin bashkuar edhe Abatesha e Manastirit prej të cilit ka zënë fill bashkësia e Klariseve, Nënë Diana Papa, Presidentja e Federatës së Puglia-s (Itali), Nënë Ludovica Loconte, dhe motra të tjera prej manastireve të Federatës.

Përkushtimi i një kishë është një ngjarje unike. Para së gjithash është një vepër e Shpirtit Shenjt. Populli i Hyjit i mbledhur në vendin e përgatitur për kultin e Hyjit dhe për dëgjimin e Fjalës së Tij, merr pjesë me fe në ritin e Përkushtimit, udhëhequr prej Bariut të vet, Ipeshkvit, dhe në bashkim me Kishën qiellore të thirrur për të ndërmjetësuar pranë Zotit me këngën e Litanive të Shenjtërve.



Pas Litanive dhe vendosjes së relikeve të Shenjtërve në altarin e ri, Ipeshkvi shpall Lutjen e Përkushtimit, me të cilën bëhet thirrje Shpirtit, shprehet qëllimi për t'ia kushtuar përjetë altarin Hyjit dhe kërkohet bekimi i Tij.

Kur një vend i kushtohet Hyjit, do të thotë, thjeshtësisht dhe jashtëzakonisht, që ai vend bëhet shtëpia e Hyjit dhe e takimit me Të e me vëllezërit nëpërmjet lutjes dhe sakramenteve.

Një kishë manastiri ka veçantinë që lind si vend kulti, pikërisht për shkak të pranisë së një bashkësie të murgeshave, siç është kjo e

Klariseve, që jeton në mënyrë të qëndrueshme në manastir dhe i dedikohet dialogut me Hyjin duke u bërë urë lidhëse, ndërmjetësie mes Atij dhe vëllezërve.

Prandaj, kisha e manastirit nuk është vetëm një kishë më shumë, por ajo bën të dukshëm misionin e veçantë të bashkësisë që me qëndrueshmëri është e pranishme në atë vend, në atë qytet.

Dritat që kanë ndriçuar dalëgdalë, gjatë liturgjisë së kremtimit të Përkushtimit, kishën e Motrave të Varfra, janë drita-simbol e Dritës së Krishtit të Ngjallur mbi këtë tokë e mbi historinë e popullit shqiptar, e cila, pikërisht në këtë vend ka shënuar, në të kaluarën, radhë të paharrueshme dhimbjeje e vuajtjeje.

Bashkësia e manastirit është sot si një vulë e vendosur prej Hyjit për t'i shprehur dashurinë e Tij një populli që Ai nuk e ka braktisur kurrë. Përkushtimi i kishës është si akti zyrtar i fundit që e fut bashkësinë e Motrave të Varfra në shoqërinë kishtarë e civile. Vetë Zoti ka caktuar kohët për të filluar e për të mbaruar punët e ndërtimit dhe nuk është rastësi që Përkushtimi ka rënë në Vitin Jubilar të Mëshirës... është një shenjë tjetër e pranisë së Hyjit që vendoset në mesin tonë, në qytetin e njerëzve për të na pajtuar me Vetën nëpërmjet faljes. Prej këtij tempulli të Hyjit në qendër të qytetit, prej Kishës së Shën Kjarës në Shkodër, do të vazhdojë të lartësohet një himn lavdi, një lutje ndërmjetësimi dhe falënderimi.



Lutja e pandërprerë rrjedh e fshehur në venat e qytetit, duke përshkuar rrugët e tij të banuara me historinë e shumë motrave dhe vëllezërve. Misioni i lutjes nuk duket, sepse është “i nënshtruar”, d.m.th. është vënë poshtë, në bazë, për të mbështetur peshën që njeriu mbart. Vetëm lutja që “i nënshtrohet” me dashuri vullnetit dashuror të Hyjit Atë, i lejon të Gjithëpushtetshmit që të bëjë vepra të mëdha në jetën e njerëzve. Lutja “e nënshtruar” bën që të kuptojmë se Hyji e ka fjalën e parë dhe të fundit mbi historinë. Fjala e Tij e parë ka krijuar njeriun duke i dhuruar dritë, Fjala e Tij e fundit ka ngjallur njeriun duke e rikrijuar për dritën e amshuar.

Imzot Jorge Mario Bergoglio shkruan para se të jshite Papë pikërisht për misionin e manastirit në qytet:

“... një himn i vogël feje, një lloj psalmi në të cilin qyteti shkëlqen si vend takimi. Feja na mëson se Hyji jeton në qytet, në mesin e gëzimeve të tij, të dëshirave të tij dhe të shpresave të tij, si edhe në dhimbjet e tij dhe në vuajtjet të tij. Hijet që shënojnë jetën e përditshme të qytetit, dhuna, varfëria, individualizmi dhe përjashtimi, nuk mund të na pengojnë ta kërkojmë dhe ta sodisim Hyjin e jetës edhe në mjediset urbane.

Qytetet janë vende lirie dhe mundësie... mundësi takimi me njerëzit dhe Hyjin, mundësi jete të vërtetë nëse ushqehemi me bashkimin... nëse mësohemi të qëndrojmë në shtëpinë e Hyjit për të rimarrë frymë e ushqim... për këtë shërbejnë kishat në qytet, janë shenjë që Hyji është në rrugët që përshkojmë! Ndoshta, pikërisht në ato që më shumë na kanë bërë të vuajmë!

DITA BOTERORE XXXI E RINISE

Në Krakov (Poloni), në datat 26-31 korrik 2016 u kremtua Dita Boterore e Rinisë, ku morën pjesë qindra të rinj nga Dioqezat tona, të shoqëruar nga disa Meshtarë, Motra si dhe nga Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pult.

PËRURIMI I OBORRIT TË KATEDRALES DHE MUZEUT DIOQEZAN

FJALIMI I DOM ARTUR JAKUT

Këtu e 158 (1858) vite më parë, në tokën e dhurime nga Marin Gjonej, populli i Shkodrës kërkonte shumë më shumë se një Kishë në mentalitetin e vizionin e kohës, kërkonte shumë më shumë se mundësitë financiare për ta ndërtuar, kërkonte dicka të ngjashme me “Duomon e Milanos”, diçka që të zinte gjithë atë etje për liri, mundësinë për të nderuar amësinë besnike të Zojës së Këshillit të Mirë.

U deshën plot 7 vite për të ndërtuar “Kishën e Madhe”, e si për ironi të fatit, u deshën shumë më tepër vite për ta rindërtuar... e kështu vazhdoi odisea e Katedrales, duke përjetuar në trup cdo fatkeqësi të Shqipërisë, me mllefin që ajo që s'impohet, dhunohet, shkatërrohet... Ngjan sikur historia biblike e Jerusalemit përsëritet në Shkodrën tonë, me ngashnjimet e të mundurës e të pamundurës, ndërtimet e shkatërrimet, adhurimet dhe sakrilegjet, madheshia e formes me përmbajtjen e madheshisë.

Kjo Katedrale, perfaqëson për Shkodrën e katolikët emblemen e një krenarie të tjetër me endjen e fantazinë së figurave më të ndritura si Imzot Luigj **çurçija**, Kolë Idromeno, Simon Rrota, Imzot Ernest **çobes**, dom Jak Sarreqit etj. Vendi që priti personalitete të rëndësishme, si Papa Gjon Pali II, Nënë Terëzën, përcolli figura si Kard. Mikel Koliqi, Atë Zef Pllumin, e forcoi sa e sa martirë në itenerarin drejt pushkatimit në Varrezat e Rrmajt, ashtu me vetëdijen e vet madheshiore.

Sa herë toka është bërë banore e qiellit, teksa tingujt puthnin pafundësinë e zemrat përjetonin kryeveprat e padëgjua të Mozartit, Shubertit, Alelujat e Ave Marieë, nga duart e Koliqit e Shantojës. Katedralja ishte si një oaz kulturor që thyente kufijtë tokësor të Shqipërisë provinciale, duke e kthyer Shkodrën në kryeqendër të zhvillimit kulturor e simotër me ato evropiane. Banda e parë e themeluar nga Palok Kurti, Kori “Schola Cantorum” i Katedralës drejtuar nga mjeshtrat Koliqi e Tonin Harapi, shenjtëronin akoma më shumë shpirtin që piqej me pedagogjinë e së bukurës e së pavdekshmes duke i sinkronizuar së bashku celebrimet fetare, me koncertet e përjavshme që mbaheshin në oborr.

Katedralja është fortesa e një besimi të martirizuar deri në ekstrem, por e pamposhtur deri në frymën e fundit, duke dhënë modelin për të cilën më shumë se kurrë kemi nevojë të frymëzohemi. Dom Ndre Zadeja kur ishte para skuadrës së pushkatimit, do të drithëronte ajrin duke klithur: “Shqypni, moj mizore, cka të baj ma shumë për ty?”

Sot, Shqipërisë, Shkodrës po i dhurojmë një muze, që do të pasqyrojë kujtimet, historinë, objektet e rralla të kultit, të ruajtura me fanatizëm, ndër vite, gjithçka e konceptuar si një promovim që i bëhet shtysës shpirtërore përmes materialeve artistike dhe personale.

Janë grumbulluar objekte nga të gjitha zonat e thella të dioqezës, dhe jam i bindur që të gjithë do të mahnitni nga dashuria, kurajoja me të cilën janë ruajtur dhe si demonstron kjo lidhje ekzistenciale që populli ka pasur me Zotin dhe me udhëheqësit shpirtërorë.

Një detaj i veçantë i këtij muzeut është edhe kendi për tingullin, përmes ekspozimit të kumbonëve të vjetra, lajmëtarëve të kohëve, që paralajmënin rreziqet që po i kanoseshin Shqipërisë, e paqësuan shpirtat e rrsakapitura me mbledhjet vëllazërore në tryezën eukaristike.

Nuk mungojnë edhe fytyrat, që të zhysin në realitetin e kohës, me pamjen e tyre prej të burgosuri pa shpresë, tretur nga indiferenca për t'i zbuluar.

Dua të falënderoj së pari, bariun e kësaj dioqeze, e prijësin e kësaj ideje, Imzot Massafren si dhe arkitektët nga Milanoja Ester Pagnoni dhe Franceska Radaelli që kanë konkretizuar projektin duke vënë në pah këtë trashëgimi të paçmueshme e të pashembulltë.

Muzeu është në sinkron me idenë e vizionit të “hapjes” që pësoi oborri i katedralës. Një vizion që përfaqëson idenë e një Kishë të hapur për të mirëpritur secilin në takimin atëror, shndërrimin e oborrit të kishës në një hapësirë për qytetin, pa mure, pa barriera, pa mburoja, e lirë, ashtu sic kisha duhet të jetë krahë-hapur.

Të nderuar të ftuar, sot kemi kënaqësinë që në emër të Qeverisë Shqiptare, të kemi të pranishme Ministrën E kulturës Znj. Mirela Kumbaron. Shfrytëzoj rastin për t'i falenderuar për mbeshtetjen që kanë dhënë në realizimin e këtij projekti.

Në këtë projekt ritheksohen motivet e mjeshtrit të madh të artit arkitektonik të quajtur ndryshe “Muzikë pa zë” të Idromenos, përdorur tek kompanjeli, tavani si dhe nxitja për ta rikthyer oborrin në një ansambel të “intonuar” me sheshin, shtatoren e martirizimit, kendin e 38 të lumëve, Katedralen dhe muzeun.

Dua të falënderoj Bashkinë Shkodër, ish kryetarin Lorenc Lukën me

të cilin e kemi inicuar këtë projekt dhe kryetaren Ademi për mbeshtetjen në vazhdimësi deri në përfundim të projekteve.

Falenderime edhe për Zotin Doshi, i cili na ka mbeshtetur në projektin endricimit.

Falenderime të përzemerta për firmen zbatuese të Mark Gjebes që ka zbatuar shumë me tëpër se çfarë ishte e parashikuar dhe sigurisht falenderime për të gjithë biznesmenet të cilët kanë kontribuar financiarisht tek pjesa e parë e projektit emrat e të cilëve janë shkruar tek libri “Nentori i Bardhi”.

Të dashur pjesëmarrës, në guri e pjesëmarrës, në guri e

themelit të Katedralës është shkruar “Dio Vede Tutto”, Zoti Sheh Gjithçka,

Ati mendjemprehtë Anton Harapi teksa kalonte nëpër zallishte drejt pushkatimit u kujdeste për të mos ju sterpikur petku nga balta, dhe ju thoshte “dua të shkoj i panjollë tek Ati”. Të heqim çdo ndryshk zemre e të angazhohemi që t'ia bëjmë njëri-tjetrit jetën më cilësore, për të rigjallëruar oborret e kishave, xhamijave, shtëpive me aromën e të bukurës, me pasionin e të bërit të gjërave ashtu sic duhet, me vetëdijen historike që ushqen vizionin e të ardhmës dhe sic thoshte Anton Harapi për të qënë gur themeli që hijëshojnë, edhe nën DHE.

Përpara se Shkodra të bëhej “Jerusalemi” i Shqipërisë, para se izmot Karl Poten ta kthente Shkodrën kryedioqezë, përpara se Ceta e profetëve të shkruhej nga imzot Pjetër Bogdani, para se Shqiponja dy krenare të valvitej në flamurin e Gjergj Kastriotit, përpara se Pal Engjulli të pagëzonte Shqipën, “para se shën Pali të ungjillizonte ilirinë, një profet revolucionoi botën, theu cdo klishe që ishte për Zotin, e shndërroi botën në Jeruzalem Shpirtëror, me vdekje mposhti vdekjen, me kryq mori lavdinë dhe shpalli të vetmin pushtet triumfues: “Hyji është Dashuri”: çdo gjë tjetër rrjedh nga kjo, e kuptohet vetem përmes kësaj...

Kjo është dashuria për të cilën ia vlen të jetohet e të sakrifkohet dhe e kjo dashuri ndriçoftë thellësitë e zemrës e i dhashtë tokës sonë martire gjithmonë modele të shpirtit shëmbëllyes.

Duke ju falenderuar për praninë e mbeshtetjen ju përshtendes me fjalët e Palit të Tarsit drejtuar bashkësisë së korintianëve: Maranatha eja o Zot Jezu.



PËRURIMI I OBORRIT TË KATEDRALES DHE MUZEUT DIOQEZAN

◀ *Vijim i fq. 4*

**ATË ZDZISLAW JOZEF KIJAS OFMCONV
RELATOR I ÇËSHTJES PËR SHENJTËRIT**

Kush është martir?

Forma më rrënjësore e mohimit të jetës personale është kushtimi i trupit, i quajtur tradicionalisht martirizim. Martiri kushton atë që ka më të çmueshme dhe e bën këtë jo për mirëqenien e vet, për rehatinë apo kënaqësinë e vet. Nuk do të kishte dashur ta bënte por mendon se vetëm kështu mund të dëftohet dashuria e tij dhe feja e tij në Jezu Krishtin, së bashku me atë që rrjedh prej kësaj.

Martirizimi nuk është vetëvrasje, sepse nëse i pari është akti suprem i dashurisë për jetën, i dyti, përkundrazi, e lufton dhe e mohon atë. Për vetëvrasjen jeta është bërë tashmë një peshë që duhet duruar, dhe ai që e dëshiron atë, kërkon t'ia heqë vetes jetën. Vdekja e tij kështu bëhet mesazhi i mohimit të tij ndaj jetës. Nëse Jezusi do të kishte dashur vetëm të vdiste, do të kishte qenë një vetëvrasës sikurse shumë të tjerë me të cilët është plot historia. Vdekja e tij do të kishte qenë pa asnjë vlerë dhe rëndësi, e ngjashme me atë të atij që bën një atentat, që vret vetveten në dem të jetës së të tjerëve.

Por ka qenë ndryshe. Martirët, ndryshe nga vetëvrasësit, japin jetën e tyre për t'u shërbyer më mirë të tjerëve. Edhe thjesht vdekja është një akt dashurie i tyre. Pësojnë një vdekje që do të mund t'u japë frytë të gjallëve. Termi "martir" nuk do të thotë gjë tjetër veçse 'dëshmitar' dhe dëshmia që jep martiri ka lidhje me një realitet pa të cilin jeta nuk do të kishte pasur asnjë kuptim. Martirizimi, pikërisht, i jep një kuptim të thellë jetës, shpreh shijen për të dhe qëllimin e saj të fundit. Në këtë mënyrë vdekja e një martiri dëshmon vlerën supreme të jetës dhe jo padomethënien e saj.

Vdekja e vë në provë të fortë fenë e çdo të krishteri. Duhet të kesh me të vërtetë një fe të fortë që të jesh në gjendje të vësh në dyshim ekzistencën tënde duke e kushtuar atë si shpërblim për një vlerë më të lartë. Forca e fesë b a z o h e t n ë jashtëzakonshmerinë e vetë jetës së Jezu Krishtit dhe të fjalëve të tij: ai – megjithëse duke qenë njeri – ka dëftuar se është bartës i një mesazhi hyjnor. Marrëdhënia e tij me Atin, udhëzimet e dobishme për

jetën, gjuha e shëmbëlltyrave, misteret e mrekullive të tij japin kuadrin e natyrës së tij hyjnore.

Jezusi nuk ishte thjesht një i urtë apo mësues jete. Vdekja e tij nuk ishte vdekja e një të dëshpëruari por e dikujt që e ka dashur deri në fund jetën e vet dhe e ka dhuruar atë si gjest dashurie për të vetët. Prandaj vdekja nuk ka sunduar mbi të por ai e ka mposhtur atë.

"Nga ku lind forca për të përballuar martirizimin?" – pyeste papa Benedikti XVI dhe përgjigjej: "(Ajo lind) prej bashkimit të thellë e intim me Krishtin, sepse martirizimi dhe thirrja në martirizim nuk janë rezultati i një përpjekjeje njerëzore, por janë përgjigjja ndaj një nisme dhe një thirrjeje të Hyjit, janë një dhuratë e hirit të Tij, që e bën njeriun të aftë të kushtojë jetën e vet për dashuri ndaj Krishtit e ndaj Kishës, dhe kështu ndaj botës. Nëse lexojmë jetët e martirëve, mahnitemi prej kthjelltësisë dhe guximit që kanë pasur për të përballuar vuajtjen dhe vdekjen: fuqia e Hyjit dëftohet plotësisht në dobësinë, në varfërinë e njeriut që i besohet Atij dhe e vë shpresën e vet vetëm në Të (krh. 2 Kor 12,9). Por është e rëndësishme të theksojmë se hiri i Hyjit nuk e shtyp e nuk ia merr frymën lirisë së atij që përballon martirizimin, përkundrazi, e pasuron dhe e lartëson atë: martiri është një person tejet i lirë, i lirë ndaj pushtetit dhe ndaj botës; një person i lirë, që në një akt unikal e përfundimtar i dhuron Hyjit gjithë jetën e vet, dhe në një akt suprem feje, shprese e dashurie, e lëshon veten në duart e Krijuesit dhe Shëlbuesit të vet; e flizon jetën e vet për t'u bashkuar në mënyrë të plotë me Flinë e Krishtit në Kryq. Me një fjalë, martirizimi është një akt i madh dashurie si përgjigje ndaj dashurisë së pafundme të Hyjit" (Benedikti XVI,

Audienca e përgjithshme. Castel Gandolfo, e mërkurë, 11 gusht 2010).

Kush janë martirët tanë?

Përzgjedhja e 38 personave-martirëve është bërë duke mbajtur parasysh burimet e disponueshme, shpërndarjen e tyre gjeografike e kronologjike, gjendjen e tyre të jetës (Ipeshkvinj, meshtarë, rregulltarë e laikë), tipologjinë e ndryshme përndjekëse së cilës i janë nënshtruar:

2 IPESHKVINJ, 21 MESHTARË DIOQEZANË, 7 Meshtarë FRETËR MINORË, 3 JEZUITË, 1 SEMINARIST, 3 LAIKË BURRA dhe 1 LAIKE GRUA.

Pra, kjo çështje është emblematike e një përndjekjeje, që qe shumë më e gjerë dhe e përhapur, që goditi në mënyrë dramatike e rrënjësore gjithë Kishën dhe përfaqësuesit e saj, duke synuar thelbësisht asgjësimin e pranisë së saj shekullore në "Vendin e Shqiponjave": vullneti për të asgjësuar praninë katolike qe një gjë e vazhdueshme e regjimit komunist të udhëhequr nga Enver Hoxha dhe ka përbërë kushtin thelbësor për shpalljen vendimtare, në vitin 1967, të ateizmit të Shtetit, që përfshiu edhe besimet e tjera.

Për kompleksitetin e kësaj Çështjeje dëshmojnë: 452 dëshmitë procesuale dhe 2047 dokumentet e mbledhura nga Komisioni Historik; puna e madhe e Censorëve historikë e teologjikë mbi shkrimet e tridhjetë e tetë Shërbëtorëve të Hyjit; realizimi i vizitave në varret e pakta që ekzistojnë për shpalljen e dekretit të jo kultit (ruhen eshtrat e vetëm 10 Shërbëtorëve të Hyjit: trupat e tjerë janë zhdukur prej regjimit me qëllimin e damnatio memoriae) etj.

Puna tejet e madhe që është dashur të bëhet shpjegon kohëzgjatjen e Hetimit dioqezan, i cili filloi, me seksionin e parë, më 10 nëntor 2002 dhe përfundoi, me seksionin e 455-të, më 8 dhjetor 2010.

Cili është mesazhi për sot?

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, më 21 shtator 2014, papa Françesku tha se të vritet në emër të Hyjit është "një sakrilegj" dhe "askush të mos mendojë se mund të nxjerrë Hyjin si mburojë ndërsa planifikon dhe kryen akte dhune e mujsharie". Dhe përballë kujtimeve të vuajtjeve të jetuara

nga një i mbijetuar, gjatë këtyre pesëdhjetë viteve të regjimit komunist, dom Ernest Simoni, sot 84 vjeç, Papa u prek deri në lot.

Në Katedralen e Tiranës të mbushur plot, ku Kisha, që është në Shqipëri, përkujtoi atë gjak të derdhur në të kaluarën, Papa pyeste: "Si ia kanë bërë të durojnë kaq shumë vuajtje?". Dhe ne mund të përgjigjemi: e kanë bërë këtë falë ndihmës së Hyjit. Forca e fesë së tyre nuk vinte prej inteligjencës njerëzore por prej dhuratës së Hyjit që i përkrah ata të cilët e duan.

Shqipëria i ka bërë ato vuajtje të së kaluarës bazën për një bashkëjetesë paqësore. Papa ishte i bindur për këtë: shembulli i Shqipërisë tregon se "bashkëjetesa paqësore dhe e frytshme mes personave e bashkësive që u përkasin besimeve të ndryshme jo vetëm është e dëshirueshme, por është edhe konkretisht e mundur dhe e praktikueshme". Nga ana tjetër, "respekti", fjala që Papa e tha disa herë në gjashtë fjalimet e tij në tokën shqiptare, është "një e mirë e paçmueshme për paqen dhe zhvillimin e harmonishëm të një populli" – tha ai. Papa u fliste edhe shqiptarëve që e pritën me gëzim e ngrohtësi të madhe. "Sikurse shqiponjat – tha ai duke cituar simbolin e Shqipërisë – fluturonin lart por mos harroni çerdhen. Mos harroni plagët, provat, por ecni përpara për një të ardhme të madhe".

Martirët shqiptarë të cilët kujtohen në këtë muzeum, janë vërtetësi si "çerdhe", si burim i kujtesës për një të ardhme më të mirë për të gjithë njerëzit që jetojnë në këtë tokë të bukur shqiptare. Kujtojnë se sa herë që Hyji dhe vlerat të cilat burojnë prej fesë shpërfillen apo luftohen, është në rrezik njeriu dhe e mira e vërtetë e vendit.



PËRURIMI I OBORRIT TË KATEDRALES DHE MUZEUT DIOQEZAN

**FJALIMI I KRYEMINISTRIT Z. EDI RAMA
LEXUAR NGA ZJ. MIRELA KUMBARO
MINISTRE KULTURE**

I dashur Imzot Massafra,

U ndjeva vërtet i prekur nga ftesa për të përshëndetur inaugurimin e Muzeut dioqezan të Martirëve të Kishës katolike në Shqipëri. Axhenda e mbingarkuar në prag të samitit të rëndësishëm të Parisit mbi integrimin evropian të Shqipërisë dhe rajonit, nuk më lejon mjerisht të jem midis Jush. Me shumë përlësi po Ju dërgoj çka kisha përgatitur si fjalë për këtë ngjarje të veçantë për Shkodrën dhe komunitetin katolik shqiptar, në shenjë pjesëmarrjeje prej dëshirës, ndonëse në mungesë.

Fryt i përkushtimit të Arqipeshkvit të Shkodrës, dioqezës së Tij dhe besimtarëve katolikë, muzeu që inaugurohet sot, do të kthehet simbolikisht, këtë vit të Jubileut të Mëshirës, në Portën e shenjtë drejt Jubileut të madh të shqiptarëve katolikë.

Ngjitja në lavdinë e altarëve të Nënë Terezës dhe 38 martirëve të persekutimit antifetar, në një hark kohor prej vetëm dy muajsh, shtator – nëntor 2016, do të jetë një moment i vërtetë provanie për t'u ndërgjegjësuar edhe njëherë, me fjalët e Shën Gjon Palit II, se ajo çka ndodhi në Shqipëri, në vitet e errëta të diktaturës, nuk duhet harruar kurrë.

Në muzeun e ri, prapa kësaj frëngjie kryqëzuar nga hekura qelie, në një mjedis që në të majtë të altarit dhe absidës, përkon simbolikisht me septentrionin e Biblës, këndin perëndimor të universit, pra këndin e vdekjes, ndodhet një dëshmi.

Kjo dëshmi diskrete, shpon mendjen dhe shpirtin me atë fjalë, për të cilën apostulli thotë se “është më e mprehtë se një shpatë me dy tehe që mbërrin deri në palcë dhe që gjykon ndjenjat dhe mejtimet e zemrës” (Heb 4,12).

Në faqen e parë të një doracaku kursi teologjike në latinisht të ateneumit të Propaganda Fides, i zellshmi nxanës i gjuhës së Ciceronit ka vendosur emrin e tij, Petrus, pa e ditur atëbotë, se transkriptimi i tij në idiomën e katakombeve do të ishte për të pararendës i martirit të tij.

Princit të apostujve, Petrus-it të parë, Zoti i ringjallur do t'i drejtohej me këto fjalë:

“I ri, e ngjeshje vetë rripin për të shkuar kah doje; porse kur të plakesh, do t'i lëshosh duart dhe dikush tjetër do të ta ngjeshë rripin për të të çuar ku ti nuk dëshiron. Me këto fjalë” – shton Gjoni Ungjilltar – “Jezusi i kumtoi se me ç'martirizim do ta lavdëronte Hyjin dhe pasi iu drejtua përsëri Pjetrit i tha: “Eja pas meje!” (Gjn 21, 18-19).

Pjetër Çuni, një nga 38 dëshmorët, përmbledh në emrin e tij fatin njëkohësisht të kobshëm e të lavdishëm, vokacionin e një Kise të rrënjësor në petrën, gurin e besimit.

Nuk ka se si, disa ditë pas kremtimit liturgjik të Shën Pjetrit, më 29 qershor, ditë shugurimi për shumë meshtarë, mos të mendosh për besojmën themeltare të Kishës: “Ti je Pjetër, ti je Guri, dhe mbi këtë gur do të ndërtoj Kishën time. Portat e Vdekjes nuk do të ngadhënjëjnë mbi të” (Mt 16, 18).

Nuk ka sesi, krahas kësaj kampanoreje të gurtë, ndaj së cilës, ndonëse e shembur dhunshëm, u përpoqën pa fund duke u shkërmoqur ideologjitë më të zeza shekullare, mos të mejtos mbi vizionin e përjetshëm mesianik të psalmistit dhe profetëve:

“Guri që përçmuan ndërtuesit, u bë guri këndor” (Ps 118, 23) “Shih, në Sion themel kam vënë një gur, thotë Zoti. Një gur këndor mbajtës, të paçmuar. Ai, i cili mbi të do të mbështetet, kurrë nuk do të përumbet” (Is 28, 16).

Në historinë e martirëve shqiptarë, sikundër në këtë vend të paqtë ku

ndodhemi sot, mjeshtërisht rimëkëmbur si pjesë jo vetëm e trupit të bashkësisë katolike, por si gjymtyrë urbane integrale e qytetit, gjeniu i përveçëm i krishterimit ka bërë të puqen simbolet me realitetin e gjallë të besimit njerëzidashës.

Muzeu, për nga ndarja në dy nivele të kujton Cenakulumin, dhomën e epërme në të cilën, në kujtim të institutimit të Eukaristisë të Enjten përpara Pashkës, qëndronin të mbledhur Apostujt ditën e Rrëshajave kur mision iu dha, të përçonin Ungjillin në të tërë botën (Vap 1,13).

Kush e ka parë dhomën e epërme në Jeruzalem, do të gjejë në këtë muze, shenjat më të prekshme të asaj vazhdimësie 2000-vjeçare të krishterimit, e cila nuk i detyrohet as luftërave, as sundimeve, as fuqisë së princërve të kishës apo të Papëve perandorë, por asaj patene të bronzit dhe asaj kupe të lakmueshme në të cilat trupëzohet sakrifica e altarit dhe kremtohet, për çdo besimtar, kthimi i Shpëtimtarit.

Muzeu nuk përbën një godinë të veçuar, apo një mjedis të shkëputur nga trupi i Katedrales. Ai ndodhet brenda saj, përnjimend ashtu si kisha në fillesat e saj, por edhe në vuajtjet më sublimate, ndodhej e fshehur në kraharorin e Zotit të saj të kryqëzuar.

Kisha lindi, kumton Ungjilltari (Gjn 19, 31), kur prej trupit të martirizuar të Krishtit në kryq, legjionari romak me heshtën e tij, nxori njëkohësisht gjak dhe ujë, gjakun e vuajtjes dhe përpjekjes dhe ujin e pagëzimit dhe shëlbimit.

Nuk është pra, besoj, rastësi, që ky muze i vuajtjes, i Ringjalljes dhe i vazhdimësisë, të jetë gur i çmuar këndor i fshehur në kraharorin e kishës katedrale të Shën Shtjefnit, Protomartiri i Krishterimit, ashtu siç kisha qëndron, përballë persekutimeve, e fshehur në kraharor të Tenzot, ashtu sikundër besimi, në tallazet e përndjekjeve dhe padrejtësive, qëndron i fshehur në kraharorin dhe zemrën e gjithsecilit.

Prej vetë domethënies çdo gjë e vyer dhe e fshehur është vektor bukurie dhe, siç u

pëlqejnë ta quajnë vëllezërit tanë ortodoksë, burim jetëdhënës.

Burim rigjenerimi dhe rilindjeje për qytetin, muzeu është guri fillestar i një nisme domethënëse të cilën shpresojmë ta shohim të kulminojë në nëntorin e lumnimit të martirëve me përfundimin e Rrugës së Kujtesës, e cila prej ish-godinës së famëkeqes Degë të brendshme, sot rikthyer në origjinë si strehë e motrave klarise, do të gjurmojë jo vetëm martirin individual, por edhe atë çka mund të quhet “kultura e dëshmisë, kultura e martirit”.

Do të jetë kjo një thirrje për të gjithë ata të rinj të tunduar nga bëma dhe sakrifica të kota, të padenja e vrastare, prej të cilave shumë shpesh jeta, në të katër anët e globit po kthehet në një therori absurde e të papërmbajtshme.

Do të jetë ky muze një dëshmi se dëshmor, martir i vërtetë është ai që ka forcën morale të thotë përpara xhelatit: “I falim ekzekutorët tanë”, bash si klerikët shqiptarë të vrarë gjatë diktaturës dhe jo kthimi në xhelat i të pafajshmëve. “Martiri”- shkruan Benedikti XVI, “është ekskluzivisht një akt dashurie për Zotin dhe njeriun, përfshirë edhe keqbërësin. Martirizimi është një akt që përjashton prej natyre urrejtjen, hakmarrjen, krimin” (Angelus, 11 gusht 2010).

Me muzeun e ri dioqezan, Shkodra, në historinë tonë qyteti i të gjitha prishmërive dhe shpresave për naltësim shpirtëror e kombëtar, kthehet në qytetin bashkëkohës të të gjitha të papriturave dhe të të gjitha shanseve për jetën që mbart kultura, dija, kujtesa, falja, e mbi të gjitha, sensi i drejtësisë së vënë në vend.

Faleminderit atyre që e bënë të mundur këtë mrekulli, e cila do të na mundësojë të rishihemi në këtë oborr, në nëntor, të gjithë së bashku, rreth lumnimit të dëshmorëve të Shqipërisë.



PËRURIMI I OBORRIT TË KATEDRALES DHE MUZEUT DIOQEZAN

FJALIMI I IMZOT ANGELO MASSAFRA OFM

Përschendes,

Imzot Ramiro Moliner Inglés, Nuncin Apostolik, Zonja Kumbaro, Ministria e Kultures, Zonja Voltana, Ademi, Kryetare e Shkodrës, Ambasadorë dhe Autoritete Civile, Atë Jozef Kijias, Relatori per Martiret tane, të dashur Vëllezër dhe Motra, këtu të pranishëm, të nderuar Operatorë të Mediave,

Nuk besoj se vetëm me fjalë arrij të shprehë mirë ndjenjat që përshkojnë shpirtin tim në këtë moment në të cilin shoh të realizohet një ëndërr e përkrahur nxehtësisht për 22 vite të gjata dhe tani më në fund e konkretizuar.

Kam ende para syve skenën e rimarrjes së objektit të parë që sot përbën njërin nga sendet e gjetura më të rëndësishme të koleksionit: një grua nga Lezha që, ndonëse me vuajtje, qe e gatshme të më dorëzojë bustin e një kryqi që u kishte shpëtuar flakëve në periudhën më të përgjakshme të përndjekjes së fesë nga ana e regjimit komunist. Kryqi i ri që i dhurova unë sigurisht do të ketë qenë për atë zonjë një ngushëllim, por për mua ai që mora prej saj kishte një domethënie të madhe simbolike. Në të njoha jo vetëm Krishtin në Mundimin e tij, por edhe të gjithë “krishtat” e kësaj toke të munduar shqiptare.

Ai është për mua, pra, jo vetëm një objekt Muzeu, në kuptimin klasik të fjalës, por sidomos rikujtimi i një realiteti që nuk duhet harruar, por përkundrazi ende duhet të kalojë plotësisht në shoshën e gjykimit historik; mbasi, duke parafrazuar George Santayana-n, nëse nuk mësojmë nga historia do të jemi të dënuar ta përsërisim atë. Pikërisht për këtë arsye, ai Krisht, ashtu si të gjitha sendet e tjera të gjetura, përbën edhe një paralajmërim të fortë për brezat e rinj për të mos e harruar të kaluarën e tyre, si atë të largët ashtu edhe atë më të vonë, por për të përfituar nga ajo për ndërtimin e një bote më të mirë.

Por, të mos mendohet se ky muze është kremtim i tjetër i një lirie të gjetur përsëri të

shprehjes dhe të besimit (edhe po të ishte, nuk do të bënte asnjëherë keq ta kujtonim). Me këtë realizim kemi dashur edhe të bëjmë të qartë se si historia e dy mijëvjeçarëve të fundit shqiptarë ka qenë një histori e krishterë. E luftuar qysh në lindje të saj, fill pas kalimit të apostullit Pal, Kisha që është në Shqipëri ka bashkëndarë ndeshtrashat e historisë së Kishës të tërë rajonit të Mesdheut: nga përhapja e mbarë në Mesjetën e Hershme dhe të Vonë, kohë të cilës i përkasin Statutet e “Shkodrës shumë të krishterë” (“cristianissima Scodra”), deri tek fshehja e saj si pasojë e pushtimit Turko-Otoman; nga rilindja e saj e shkurtër e viteve të para të shekullit të kaluar deri te shtypja e re komuniste; nga rifillimi pas demokracisë deri në ditët tona.

Është e vërtetë, historia nuk mund të gjykohe me parametrat tanë: ajo vetëm mund të studiohet dhe hulumtohet, por kryesisht duhet të pranohet për atë që është. Megjithatë, historia është edhe mësuese jete dhe patjetër mund të na ndihmojë për të mos përsëritur në të tashmen të njëjtat gabime të së kaluarës. Prandaj duhet të njihet në të vërtetën e saj dhe t’u përçohet breza të rinj të cilëve u është besuar e ardhmja e Kombit.

I është kushtuar shumë kohë përshkrimi të hollësishëm historik të së kaluarës sonë dhe atij kemi dashur t’i japim një hapësirë të gjerë brenda Muzeut: ai do të jetë udhërrëfyese i vërtetë i vizitorit që do të jetë i shoqëruar në një lloj “udhëtimi në kohë” i pasuruar me sende të gjetura që shënojnë ecjen e saj të lavdishme dhe të vuajtur. E kadencat historike janë grupuar në tematika të veçanta që i thellojnë dhe i shpjegojnë ato. Një “shtegtim” që ia vlen ta bëjmë nëse dëshirojmë të arrijmë në një vetëdije që, për fat të keq, e shohim se mungon sot tek një pjesë e madhe e njerëzve tanë.

Kështu, ky Muze, shndërrohet në një vepër didaktike në kuptimin e mirëfillt të fjalës dhe këtij funksioni formues do t’i kushtojmë pjesën e dytë të Muzeut që shpresojmë të hapim në muajt e ardhshëm në lokale të reja, ku

do të vendosen shumë objektet dhe sende, të cilat, për arsye hapësirë, nuk janë ekspozuar tani (për këtë them atyre që nuk shohin tani gjërat... mos merziten... sepse do t’i shohin sa më shpejt!) me sende të reja të gjetura dhe me një seksion multimedial që do të lejojë për të zhvilluar cikle konferencash dhe seksione të mirëfillta studimi dhe thellime me një program të sheshtuar më parë me ndihmën e përfaqësuesve të kulturës shqiptare dhe që u drejtohet të gjitha shkallëve të itinerarit formues të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve.

Më në fund, ky Muze gjen në hapësirën e Katedrales (ajo vetë një copë e historisë të Kishës sonë) vendosjen e tij zyrtare; megjithatë është një Muze “në lëvizje”: qoftë ngaqë në të gjenden referime ndaj vendeve arkeologjike të shpërndara në territor, qoftë ngaqë është qëllimi ynë ai për të vendosur lidhje dhe kontakte me realitete të tjera Muzeale jo vetëm të Shqipërisë por edhe të tërë rajonit ballkanik për të nxitur, kështu, zhvillimin e turizmit kulturor në tokën tonë.

Ja, ndoshta tani mund të kuptohet më mirë gëzimi im për këtë realizim të mbarë që, për këtë jam i sigurt, do të marrë edhe pëlqimin e ju të pranishmëve duke ju falënderuar që e keni pranuar ftesën, dhe e të gjithë atyre të cilët që sot e tutje do të dëshirojnë ta vizitojnë Muzeun tonë Dioqezan të Shkodër-Pult.

E përfundoj fjalimin tim me disa falënderime që e kam për detyrë t’ua bëj. FALËNDERIME: Don Nikolin Toma, Vikari Gjeneral, Dom Artur,

Jaku, Administrator Famullitar, Arkitektet: Ester Pagnoni Yembi, Francesca Radaelli, Anna Camisasca, Për inventarin dhe tekstet: Atë Luigi Aluisi OFM.

F i n a n z u e s i t :
Konferenca Ipushkvnore Italiane – CEI, Konferenca Ipushkvnore USA, Arqidioqeza Shkodër-Pult, Princesse Marie Liechtenstein.

Një falenderim i përzemërt shkon për të gjithë ata që dhuruan v e p r a r t i d h e dokumente, apo i vunë ato në dispozicion të fondit të muzeumit. Falenderojmë po ashtu edhe të gjithë ata që kontribuan me rezultatet

e studimeve dhe punës së tyre kërkimore në pasurimin e mëtejshëm të këtij muzeumi. Falenderoj Dom Gjergj Simonin, i cili ka dhuruar shume sende.

Arkeologët: z. Gëzin Hoxha dhe z. Zamir Tafalica

Përkthyesit: Luket Hasaj, Angjelina Gjeka, Vladimir Banushi

Këshilltar për anën historike: Z. Villy Kamsi dhe z. Gjovalin Çuni

Grafikë: Erica Koumbang o' mbai Pagnoni

Dokumentarët në video: Z. Adrian Paci, Z. Simeon Daberdaku, Centro TV Vaticano, TV2000 (CEI),

Disa kontributet nga Vendi

Dhe Maestro Luka Mllugja dhe Korin per kenget e Zojës.

Për realizimin e ndërhyrjeve arkitekture: Franc Hila, Gjovalin Gjergji dhe vullnetarë.

Për realizimin e punimeve të brendshme:

Për Grafikën/print/plexiglass: Lufastudio

Hekurpunuesë: Leonard Qyteza dhe Fredi Qyteza

Për karton gjeso dhe bojatisjen: Elton Sopi me bashkëpunëtorë: Pëllumb Malaj, Florian Pepushaj, Fred Marku. Për raftat druri: Dafinor (Vëllezër Kakja) dhe Gjergj Firmosi. Për kondicionator air: Alfred Zefi me Nard Ndreka e vullnetarë. Për elektrikun: Pëllumb Gjeçaj me Çesar Bala, Tonin Maka. Për video-kamerat: Arshen Tafalica. Për internet: Gjergj Ejlli dhe Sandër Peraj (I.B.C.). Vullnetarët: Paulin dhe Meri Ujka, Florenc Nika.

Restauratorët: z. Hasan Nallbani, z. Mark Pjetri, z. Mikel Çurçia.

Per restaurimin e vuleve: z. Tonin Palushi, z. Gëzim Kraja.

Photo copyright

©Fototeca Marubi, Shkodër, ©Angjelin Nenshati, Shkodër,

©LuPhotography, Shkodër, ©Arkivi i Shtetit

©Biblioteca Medicea Laurenziana, Firenze.



VIZITA E IPESHKVINJVE TË KRAHINËS SË PIEMONTE NË SHQIPËRI



Më 11 korrik në orën 17.00 isha tashmë në aeroport, në Rinas, së bashku me Fr. Vincenzo Focà për të pritur 13 ipeshkvinjtë e Piemontes në vizitë në Kishën shqiptare. Po realizohej një ëndërr që kishte filluar në dhjetor të vitit 2014 kur, i ftuar në Kuneo për shugurimin ipeshkvor të Imzot Aldo Gioradano, Nunc Apostolik në Venezuelë, kalova dy ditë në Mondovì me Imzot Luciano Pacomio, me të cilin qemë shuguruar ipeshkvinj të njëjtën ditë nga Shën Gjon Pali II.

Në atë rast, e ftova të vinte në Shqipëri dhe, meqenëse Ipeshkvinjtë e Piemontes kanë në program të shkojnë çdo vit në ndonjë vend për të njohur realitetet e tjera kishtarë, ja që për këtë vit zgjodhën të vinin në Shqipëri.

Sapo arritëm në Shkodër, i shoqëruam pranë Hotel Colosseo për darkën dhe fjetjen. Pasi të pushonin mirë do të merrnin pjesë pastaj në Programin e përgatitur pikërisht për ta.

E martë, 12 korrik – Shkodër: Ditë interesi baritor dhe për një thellim mbi ngjarjet dramatike të krishterimit në Shqipëri.

Pas Kremtimit të Lavdeve të Mëngjesit pranë Kishës së Sh. Françeskut në Gjuhadal, shkuam për vizitë në Varrezat katolike të Rrmajt, vend i pushkatimit të disa prej Martirëve tanë.

Pastaj vizituan, të drejtuar nga unë, Muzeun Dioqezan, Katedralen dhe Kurien. Nga këtu shkuam në Fshatin e Paqes ku qe edhe dreka së bashku me Ipeshkvinjtë e tjerë shqiptarë.

Pasdite shkuam në Vizitë në Manastirin e Klariseve dhe në Memorialin e Martirizimit, vizitë që përfundoi me kremtimin e Mbrëmësorës së bashku me Motrat Klarise. Në orën 18.00 Bashkëkremtimi Eukaristik në Katedrale, me praninë edhe të

meshtarëve dhe rregulltarëve të tjerë, në përfundim të së cilës morëm pjesë në ndarjen e çmimeve të fituesve të konkursit të pikturës dhe atij poetik-muzikor të organizuar në kuadrin e kremtimeve për Lumturimin e Martirëve tanë, për të cilin u bë shpallja solemne dhe zyrtare pikërisht me këtë rast. Edhe ata u gëzuan së bashku me ne për shpalljen e datës që do të jetë më 5 nëntor 2016 në Shkodër, në praninë e Kard. Angelo Amato, Prefekt i Kongregatës për Çështjet e Shenjtërve.

E mërkurë, 13 korrik – Shkodër / Tiranë: Dita "Laudato sii". Në udhëtim drejt vendeve me interes natyror në veri të Shqipërisë.

Në orën 7.30 u nisëm drejt Komanit dhe në pjesën e bërë në autobus kremtuam Lavdet e Mëngjesit. Pastaj, me një anije të vogël lundruam nëpër liqen dhe, para kthimit, një zhytje e vogël në ujë për ata që deshën dhe dreka në një lokal me administrim familjar ku gjetëm një mikpritje të ngrohtë.

Në kthim vizituan Katedralen e Dioqezës së Sapës me një lutje pranë varrit të të ndjerit Imzot Lucjan Avgustinit, dhe përsëri në autobus drejt Lezhës, ku bashkëkremtuam pranë Kuvendit Françeskan.

Ajo që na ofruan fretërit françeskanë qe i mjaftueshëm për të arritur në Tiranë ku u vendosëm pranë International Hotel.

E enjte, 14 korrik – Tiranë / Malpensa: Dita e Mëshirës.

Dita filloi me kremtimin e Lavdeve të Mëngjesit në Katedralen e Tiranës, nga ku pastaj shkuam në vizitë në Katedralen Ortodokse. Këtu u



pritëm me vëllazëri nga Imzot Andoni dhe Imzot Asti, i cili na foli për përshpirtërinë ortodokse.

Nga këtu drejt Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ku gjithashtu u pritëm me ngrohtësi dhe na u paraqitën veprimtaritë e universitetit. Më pas shkuam në Nunciaturë ku patëm takim me Nuncin Apostolik, i cili na priti vëllazërisht dhe ndërveproi me mysafirët tanë.

Në orën 12.30 ishim në Bubq, pranë "Shtëpisë Betani" ku na prisnin me ankh të fëmijët, të rinjtë dhe edukatorët e qendrës, së bashku me dom Françeskun. Kremtuam Meshën e shenjtë të animuar prej të njëjtëve të rinj dhe hëngrëm drekë të gjithë së bashku. qe një përvojë e bukur dhe prekë me dorë një prej veprave të Kishës katolike në Shqipëri: kujdesin për të braktisurit dhe për të dobëtit dhe/ose personat me aftësi ndryshe.

Para shkuarjes në aeroport ku pastaj morëm fluturimin për t'u kthyer në Itali, u përshëndetëm duke falënderuar njëri-tjetrin: ne për praninë e tyre të çmueshme dhe Ipeshkvinjtë Piemontezë sepse kishin njohur "Martirizimin" e një Kise për të cilën dinin pak. Kjo është bukuria e bashkimit kishtar!

+ Angelo Massafra OFM



Bubq

AKTIVITETE RINORE DIOQEZANE



Të vihesh në shërbim të të rinjve është një kantjer I hapur

Të punosh me të rinjtë dhe për të rinjtë, sot më shumë se kurrë, është një sfidë dhe një prioritet. Në Dioqezën tonë, falë bashkëpunimit dhe përgaditjes së shumë personave, janë përcjellë shumë nisma dhe aktivitete në favor të të rinjve. Puna me të rinjtë është e dashur prej të gjithëve, pasi jemi të vetëdijshëm se janë pasuria më e shtrenjtë për Kishën dhe për shoqërinë. Mbi shpatullat e tyre, mbartet e ardhmja e një vendi, e ardhmja e familjeve të shëndosha, e ardhmja e një klase drejtuese, në këtë mënyrë lista mund të tejzgjatet pafund.

Duke u nisur nga kjo rëndësi e patjetërshme objektiv kryesor ka qënë dhe mbetet për ne formimi i të rinjve. Komisioni Baritor Rinor ka ndërmarrë inisjativat lidhur me objektivin e formimit. Dëshira për të njohur Shkrimin e Shenjtë ka bërë që për tri vite radhazi të zhvillohen takimet mujore me dom Simo Luliq, duke u mundësuar kështu të rinjve takime mujore për të shuar sadopak etjen për të njohur më mire Biblën.

Itinerari shpirtëror për adoleshentët ka qënë një tjetër përvojë një mujore, ka dhënë një kontribut të madh në bashkëndarje mes grupeve të ndryshme të dioqezës dhe në formimin personal me anë të reflektimit, të lutjes dhe sakramentit të pajtimit.

Formimi i Animatorëve në nivel dioqezan është në vitin e tretë të ecjes. Çdo vit të rinj të grupeve dhe famullive të ndryshme kanë marrë

pjesë në këtë formim për të qënë bashkëpunëtorë për të mirën e bashkësisë në vendet ku ata jetojnë. Formimi zgjat gjithsej tri fundjava gjatë vitit dhe përfundon me një javë kamp. Në vitin e tretë të formimit, pohoj me shumë kënaqësi, vlerësimin nga të rinjtë dhe dëshirën për të përvetësuar metoda të reja qoftë në fushën pedagogjike, të animimit dhe shpirtëror.

Në këtë vit Baritor është ndërmarrë edhe inisiativa e takimit shpirtëror me universitarët. Të rinjtë një ditë në javë, në Kishën e Shën Kollit, kanë pasur mundësinë e rrëfimit, bisedës shpirtërore dhe Meshën e Shenjtë të ofruar nga Atë Adolfo dhe bashkëvëllezërit Karmelitanë. Liturgjitë pendestare në kohët e forta, momentet e Katekezave të udhëhequra nga Mons. Angelo Massafra, u kanë dhënë të rinjve një shtysë në formimin e tyre. Të vihesh në shërbim të të rinjve është një kantjer i hapur. Jam e vetëdijshme se ngelet akoma shumë për t'u bërë në shërbim të të rinjve. Të rinjtë Universitarë duhet të bëhen prioritet kryesor i punës tonë baritore, ata që janë më larg Kishës, ata që janë në vartësinë e veseve dhe pa motivacion për jetën.

Në muajin prill kam marrë pjesë në takimin Evropian të Baritores Rinore në Szeged-Hungari, ndër të tjera është vëndosur theksi në shoqërimin e të rinjve në fazat kryesore të jetës në mënyrë që të jetojnë jetën me gëzim, të zbulojnë bukurinë dhe ato dhurata të shumta që kanë t'i vendosin në praktikë.

Sfida e punës Baritore me të rinjtë dhe në favor të të rinjve, bëhet në të njëjtën kohë edhe sfida e ne të rriturve që të dimë t'i drejtojmë e t'i shoqërojmë në ecjen e tyre të formimit dhe si rrjedhojë të bëjnë zgjedhjet e duhura dhe të pjekura në jetën e tyre.

Motër Rita Ndoci



NJOFTIM ZYRTAR PËR DITËN E BEATIFIKIMIT TË “MARTIRËVE” TANË

Pas një kohe relativisht të gjatë, me një punë voluminoze dhe me angazhimin e palodhshëm për të arritur deri në përmbylljen e procesit kanonik, në njohjen dhe në pranimin zyrtar të dëshmisë flijuese për Fe dhe Atdhe, të Imzot Vinçens Prennushit dhe 37 Shokëve të tjerë, erdhi momenti që tani solemnisht të shpallim datën historike të Rritit të Lumnimit e të Naltimit në altar të 38 bijëve tanë. Procesi dioqezan i filluar me 10 nëntor 2002 e mbyllur me 8 dhjetor 2010...u analizua nga ekspertet e Kongregatës për Çështjen e Shenjterve...dhe me dekretin që Papa Françesku firmos me 26 prill 2016 u dekretua se mund të shpallen të Lumë.

Më në fund, me letrën që Ati Shenjte, Papa Françesku na ka derguar përmes Sekretarisë së Shtetit të Vatikanit, **na konfirmon se data e Kremtimit do të jetë 5 NENTOR 2016.**

Vendi i kremtimit do të jetë: Sheshi i Katedrales së Shën Shtjefnit, Shkodër.

Riti i Lumnimit do të udhëhiqet nga Prefekti për Çështjen e Shenjtërve, Eminenca e tij Kardinal Angelo Amato.

Me këtë shpallje, kemi plotësuar të gjitha detajet e nevojshme. Tashmë, na takon neve që t'i naltojmë e të përgatitemi për t'i nderuar me festën tonë të hareshme shpirtërore. Si Arqipeshëv që ka çuar përpara procesin e Martirëve, me ekipin e gjyqit kishtar që falënderoj, si Arqipeshkëv i Vendit ku do të kremtohet Mesha e Lumnimit dhe në emër të Konferencës Ipeshkvore, Ju bëj thirrjen dhe ju nxis për të kremtuar sa më denjësisht këtë moment historik për Kishën dhe Kombin. Zoti Ju bekoftë!

Shkodër, 12/07/2016

+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Phkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë

MONS. FRANCESCO MARIA GRECO SHPALLET I LUM

Me 26 korrik 1857 lind në Akri Francesco Maria Greco nga prindër me bindje të thellë fetare. Qysh fëmijë udhëhiqet nga nëna e tij në udhën e besimit. Pasi mbaroi gjimnazin shkollon në Napoli në vitin 1874 për të kryer liceun. I ati shpresonte t'i trashëgonte të birit zanatin e farmacistit në Akri. Por, Francesco zgjedh jetën meshtarake, forcon lutjen, në këmbët e Virgjëres së Pompeut, duke realizuar kështu thirrjen e tij dhe duke mposhtur rezistencën e të atit. Me 17 dhjetor 1881 bëhet meshtarë dhe kthehet në Napoli ku përfundon mësimet universitare për doktoraturë në teologji. Në shtator të 1887 emërohet famullitar në kishën e Shën Kollit në Akri. Zelli apostolik, shpirti i sakrificës dhe i dhurimit, feja e gjallë dhe vepruese, shumë shpejt do të tregojnë se janë bërthama qëndrore e jetës së tij që karakterizojnë figurën njerëzore dhe shpirtërore të Mons. Françeskut. Vepra e tij edukuese, e

drejtuar para së gjithash rinisë, ka si qëllim që "duke edukuar në fe edukohet në jetë". Punëtor i ungjillit, është i bindur që injoranca fetare, nga e cila lindin mjerimet morale, është plaga më e dhimbshme e Kalabrisë së kohës së tij, prandaj themelon në famulli shkolla katekeze, shoqata, një orator interfamullitarë, dhe me bashkëpunimin e Motër Maria Tereza De Vincenti themeloi Institutin tonë të Motrave Punëtore të Vogla të Zemrave të Shenjta duke i ftuar që të kuptojmë thirrjen tonë, Ai ju thoshte bijave të tij që Punëtorja e vogël e Zemrave të Shenjta është e thirrur që të sodisë, jetojë, imitojë dhe të dëshmojë Zemrat e Shenjta.

Shpirtërimi i tyre është, që në qënder të jetës së tyre të jenë Jezusi dhe Maria. Qëllimi është ungjillëzimi dhe promovimi njerëzor ndaj të vegjëlve, të rinjve dhe më nevojtarëve.

Mënyra e jetës sonë duhet të ketë të njëjtat ndjenja që kishin Jezusi dhe Maria, përvujtëri, butësi, dashuri, zemërgjërsi, etj. Gjithçka të bëhet për mbretërinë e qiellit.

Siç vihet re Dom Francesco ka qenë i frymëzuar nga Zemrat e Shenjta që ai dhe kongregata e tij të lindin në famulli dhe për famullinë, sikur edhe ai vetë ju shkruante motrave: "keni lindur nga Eukaristia, punoni me Eukaristinë, dhe jetoni për Eukaristinë".

Don Françesko nuk ndalet për të ndihmuar popullin e vet në Akri, por merr shumë për zemër popullin italo-shqiptar. Ky popull ishte larguar nga Shqipëria për shkak të pushtimit turk. Dhe pikërisht në 1917 Motrat Punëtore të Vogla të Zemrave të Shenjta hapin shtëpinë e parë në Shën Demetrio Corone (Cs), pastaj Lungro, Vaccarizzo, Firmo, Shën Bazile, Shën Benedetto Ullano, Shëntja Caterina Albanese. Diçka të veçantë që kishin këta vende ishte fakti që jetonin ritin greko-bizantin, ritin oriental. Por kujdesi apostolik që patën themeluesi Don Francesco Maria Greco dhe bashkëthemeluesja Maria Teresa De Vincenti ndaj këtyre bashkësive italo-shqiptare bëri që Instituti të hap horizontin dhe të marrë pjesë në misionin e kishës që ishte kërkimi i marrëdhënieve vëllazërore me kishën orientale.

Mons. Francesco Maria Greco dëshiron të jetë i varfër ndër të varfër për të qënë "zëri i atyre që s'kanë zë". Intuita profetike e tij bën që të kuptojë rëndësinë e të hapurit ndaj veprave edhe në komunitetet italo-shqiptare, të ritit grek bizantin, të pranishëm në Kalabri dhe në Sicili, të cilët kishin nevojë për asistencë shpirtërore dhe materiale. Me 26 tetor 1917 filloi kështu një vepër që në të ardhmen do të jetë shënjë shprese për ecjen ekumenike, dhe shënjë dalluese e origjinale e Kongregatës. Sekretet e veprave të shumta qëndron në soditjen e Zemrave të Shenjta, që diakoni i ri Zemrat e Shenjta iu bënë modeli i jetës së tij. Në bazë të jetës së tij meshtarake mbetet lutja e thellë dhe e tejzgatur, shpesh herë gjatë natës, përballë Eukaristisë, e kështu kujdesi i vecantë për jetën e brendshme, i sigurt që frytshmëria e veprave apostolike varet nga marrëdhënia intime dhe e thellë me Jezusin dhe Marinë.

Pa kaluar shumë vite fillon të realizohet edhe ëndërra e themeluesit për të hapur misionin në tokën e Shqipërisë, dhe kjo ndodh me 29. 02.1940, për herë të parë motrat ndalen në Jug të Shqipërisë në Vlorë, Vunë e Dhermi, ku ato filluan misionin e tyre duke ungjillëzuar e duke promovuar qënien njerëzore. Duke pasur parasysh misionin apostolik që Zoti ju kishte besuar nëpërmjet themeluesve, dhe ky mision ishte fokusuar në idenë dominuese që: "duke edukuar në fe edukohet edhe në jetë". Por fatkeqesisht ky mision i motrave

nuk zgjati shumë për shkak të rëgjimit komunist, në 1945 motrat ishin të detyruara që të ktheheshin në Itali duke lënë misionin e tyre.

Dhe pas regjimit komunist motrat kishin të qartë sa për zemër e kishte pasur themeluesi popullin shqiptar dhe serish kthehen në Shqipëri, me 16.10.1994, por kësaj radhe motrat nuk ndalen në Jug por në Veri ku si fillim u vendosen në Piraj dhe në Kodhel të Lezhës, po ashtu edhe në Kryezi të Pukës, Shkoder, Lohe-Dedaj (Malësi e Madhe), ku në këto vende filluan të dëshmojnë karizmen dhe shpirtërimin e tyre, ungjillëzimin dhe promovimin njerëzor.

Dëshiroj të theksoj që Dom Françesko ka qenë gjithmonë i vëmendshëm ndaj "shënjave të kohërave" Si shërmendi i lidhur me hardhinë, Ati i ynë Themelues ka sjellë fryte të shumta baritore e shënjtërimi dhe vazhdon të jetojë mes nesh përmes veprave të tij të ungjillëzimit e të dashurisë të shpërndara në Itali dhe jashtë saj si në Amerikë, Argjentinë dhe Indi.


Ka jetuar një eksperiencë të fortë në Shpirtin e Shenjtë, po ashtu u ka trasmetuar ndjekësve të tij që ta jetojnë, ta ruajnë dhe ta përhapin përvojën e tij me Shpirtin e Shenjtë. Një vëmendje të vecantë u ka kushtuar kohërave në evolucion sa që shkruan që t'i përshtatemi kohës dhe vendit. Ka përfaqësuar të gjitha varfëritë e ndryshme të epokës se tij ku ka jetuar, vëmendje të vecantë ndaj të rinjëve, të varfërve e fëmijëve jetime, të braktisurve dhe në vecanti të nëpërkëmburve. Gjithashtu i kushtoi vëmendje të vecantë injorancës fetare që jetohej në ato vite në Akri.

Dita e tij tokësore përfundoi në Akri me 13 Janar 1931. Eshtrat e tij pushojnë në Kishën e Shën Françeskut të Paulit pranë Shtëpisë nënë në Akri. Me 24 maj 1961 u bë inspektimi i rregullt kanonik. Pasi u përhap fama e shënjtërisë së jetës së tij, me 8 dhjetor 1957 filloi procesi i kanonizimit, për të pranuar ushtrimin e veprave heroike të vrytyteve të krishtera. Jo vetëm filloi procesi i kanonizimit por si çdo jetë shënjterie eci përpara procesi falë edhe një mrekullie që ai ka bërë duke

ndërmjetësuar për një grua, Nina Pancaro, nga Altomonte provincë e Kozencës e cila ishte prekur nga një semundje e rende në të cilën ishte e nevojshme një ndërhyrje kirurgjikale dhe si pasojë e saj ajo hyn në koma. Pas disa ditësh zgjohet dhe u tregon mjekëve dhe familjareve se ka parë një ëndërr me një prift që i ishte prezantuar si Francesco Maria Greco dhe i kishte garantuar shërimin dhe kthimin tek familja e saj. Postulatori Atë Giovanni Giuseppe Califano ofm i cili e ka ndjekur me shumë kujdes procesin e lumturimit ka vënë në dukje pasurinë e këtij meshtari dioqezan i cili ka themeluar jetën e tij në Zotin duke vepruar në Kishën dhe për Kishën e cila është sakrament bashkimi mes njeriut dhe Zotit, falë edhe këtij kujdesi ndaj veprave që ai ka realizuar gjatë jetës së tij ia arriti edhe dita e lumturimit me 21.05.2016. Një kremtim i udhëhequr nga Eminenza e tij Kardinal Angelo Amato, përfaqësues i Atit të Shenjtë dhe Prefekt i Kongregatës për Ceshtjen e Shenjtëve, ku theksoi që për të qenë famullitar për atë do thoste të zhvillonte misionin e tij si samaritani i mirë duke i shëruar plagët gjithë atyre që Zoti i vendoste pranë në udhëtimin e tij. Dhe akoma theksoi Don Francesco ishte njeri me kulturë dhe kishte shumë për zemër predikimin dhe administrimin e sakramentit të pajtimit, kishte kujdes të madh ndaj të rinjve, adoloshenteve, të vegjëlve dhe më nevojtarëve etj.

Në këtë celebrim mijëra besimtarë morën pjesë për t'i dhënë lavdi Zotit. Në mes tyre një nga këta pjesëmarrës i rëndësishëm edhe për gjithë kongregatën tonë ishte dhe Shkëlqësia e tij Imzot Angelo Massafra i cili na nderoi me praninë e tij, jo vetëm na nderoi por na manifestoi të njëjtën dashuri që themeluesi ynë ka pasur dhe vazhdon të ketë nëpërmjet motrave ndaj popullit arbëresh dhe popullit shqiptar. I pranishëm së bashku me Shkëlqësinë ishte edhe Fra Vincenzo Foca ofm. Ishin të pranishme motrat tona të ardhura nga gjitha misionet ku ne punojmë në Itali, Shqipëri, Amerikë, Argjentinë, Indi, Po ashtu ishin të pranishëm edhe vëllezërit dhe motrat tona agregate laikë dhe të gjitha famullie ku ne punojmë.

Motër Marjeta Gjoka



LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

MESHË FALENDERIMI
PËR LUMTURIMIN E FRANCESKO MARIA GRECO

Në famullinë e Shën Shtjefnit në Blinisht, në kishën e Martirëve Shqiptarë, pasditen e së dieles me 19. 06. 2016, është kremtuar një meshë falenderimi me rastin e Lumturimit të Francesko Maria Greco, meshtar dhe Themelues i Kongregatës së Motrave të Vogla Punëtore të Zemrave të Shenjta.

Bashkësia e Motrave të kësaj kongregate, populli i Zotit, famullitari don Enzo Zago e meshtarë të tjerë, u bashkuan në këtë meshë shenjte të udhëhequr nga administratori dioqezan i Sapës, dom Simon Kulli, me falenderimin ndaj Hyjit për dhuratën e Lumturimit të Francesko Maria Grecos.

Është kjo një ngjarje e cila na gëzon të gjithëve ne popullin e Hyjit, gjallëron Kishën dhe e zbukuron atë me të lumë dhe shenjtër. Do ishte bukur që në këtë kremtim të shenjtë të kishte qenë mes nesh edhe bariu ynë Mons. Lucjan Avgustini, por jemi të sigurtë që Ai është me ne shpirtërisht, e na shoqëron në këtë festë nga qielli. Ishin këto fjalët e dom Simonit Kullit



që shoqëruan fillimin e krenimit të meshës, i cili mes emocioneve kërkoi që në lutjet e secilit prej nesh të porosisim edhe shpirtin e bariut tonë që tashmë gëzon në amshim.

Gjatë predikimit të tij, dom Simoni u ndal në jetën dhe veprën e të Lumit Francesco, i cili e pati fort për zemër Mësimin e Fesë. E ndërsa shpesh thoshte: “të edukosh në fe do të thotë të edukosh në jetë”. Duke vazhduar më tej, dom Simoni solli një tjetër fakt se i Lumi Francesco ishte shumë i lidhur me shqiptarët që jetonin në Jugun e Italisë. Edhe atyre deshi t'ua mësonte të vërtetat e fesë duke përpiluar një katekizëm të veçantë për Arbëreshet tanë. Një dashuri e tillë ndaj popullit tonë do shfaqej edhe më tepër me ardhjen e motrave të themeluar prej tij në Shqipëri në vitet 1940, ku do

vendoseshin për të jetuar në Vlorë. Ndërsa pas rënies së komunizmit, në vitin 1994, ato u vendosen përfundimisht në Piraj të Zadrimës, duke hapur kështu një mision të ri në tokë të re.

DOM SIMON KULLI ZGJIDHET
ADMINISTRATOR DIOQEZAN I SAPËS

Me ndarjen nga jeta të Ipeskëvit të Sapës, Imzot Lucjan Avgustini, Selia e Sapës mbeti vakante. Për këtë arsye, me 26 maj 2016, në një klimë vëllazërore u mblodh Këshilli i Konsultorëve të dioqezës, për të zgjedhur administratorin dioqezan.

Takimi u udhëhoq nga famullitari i famullisë së Shën Shtjefnit Blinisht, Don Enzo Zago si meshtari më shumë vite meshtarie. Pas diskutimeve të ndryshme u bë votimi ashtu siç e parashikon edhe Kodi i të Drejtës Kanonike. Me shumicë votash, ish Vikari Gjeneral, don Simon Kulli u zgjodh Administrator Dioqezan.

Dom Simon Kulli është ndër të parët meshtarë shqiptarë, që u shuguruar në vitin 2000. Jeta e tij meshtarake prej 16 viteve ka një

veprimtari të shquar jo vetëm në pastoralen dioqezane e në mbarështimin e sakramenteve, por edhe në strukturat drejtuese. Gjatë këtyre viteve ka ushtruar shumë detyra në mbarëvajtjen e jetës dioqezane, si: sekretar, kancelar, ekonom, drejtor i Caritasit, drejtor i Fondacionit Drita dhe së fundi Vikar Gjeneral i dioqezës. Që prej 10 vitesh, është famullitar i Katedrales Nënë Tereza në Vau-Dejës.

Me zgjedhjen e tij në krye të Dioqezës, Dom Simon Kulli premtonte se së bashku me Klerin dioqezan, do të vazhdojë të ndjekë gjurmët e ipeshkëvit të ndjerë, Imzot Lucjan Avgustinit, e do ta çojë përpara misionin e ungjillëzimit, punën dhe veprimtarinë e gjithë dioqezës së Sapës.

Violeta Marashi

Arqidioqeza Metropolitane Shkodër-Pult me gëzim njofton se me datën 12 korrik 2016 u bë ndarja e çmimeve për konkurset poetik –muzikor dhe piktorik: “Himni për Lumnimin e Martirëve tanë” dhe “Prandaj Hyji i Lartësoi...”




Krezmime në: Ukbibaj



... Logegaj (Shllak)

Koplik



Krakovë



Krakovë



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Registrohu në kanalin tone!

Ngjarjet Kisha Katolike Shkoder Pult

Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqësja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë